

## Rezultatet e zgjedhjeve lokale të 8 majit 2011 në Shqipëri

**Të gjithë vëzhguesit zgjedhorë bashkohen tashmë në një pikë: se ka pasur një garë të fortë, në një klimë të polarizimit të madh politik dhe mosbesimi të thellë mes partive të koalicionit qeveritar ( PD, LSI, PR) dhe partive të opozitës (të udhëhequra nga PS). Siç është bërë e zakonshme në Shqipëri, humbësi i zgjedhjeve shfaq dyshim për rezultatin përfundimtar. Nga Partia Socialiste, rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2009 deri më sot, akoma nuk është njohur.**

Partia Demokratike i fitoi zgjedhjet për kryebashkiakë me një koalicion të shtrirë në mbarë vendin, me një shumicë prej rreth 70.000 votash, ndërsa në zgjedhjet për këshillat bashkiakë madje, edhe me një shumicë prej 172.000 votash. Në qytetet e mëdha dhe ato të mesme, Partia Socialiste mundi megjithatë të dilte fituese. Rezultati i PD-së, porë në mbarë vendin - ishte jo fort mbresëlënës. Në qytetin e Shkodrës, PD-ja mundi të fitonte të tjerë zgjedhës dhe në rajonet qendrore dhe ato periferike të Tiranës, gjithashtu, PD-ja mundi të kornte sukses.

Rezultati në kryeqytetin Tiranë ishte mëse i ngushtë dhe për PD-në shumë i rëndësishëm. Atje shefi i opozitës, Edi Rama ( kryebashkiaku i deritanishëm i Tiranës) doli në garë përballë ish-Ministrit të Brendshëm, Lulzim Basha. Vetëm pas rinumërimit të votave në disa njësi zgjedhore dhe ankimit të rezulttit nga ana e PS-së, u bë e qartë se tashmë fitues ishte PD me kandidatin e saj, Basha, i cili ka fituar me një distan-

cë prej rreth 80 votash më shumë. Për liderin e opozitës, Rama, kjo është një humbje e dhimbshme.

Zhvillimi korrekt i procesit zgjedhor është një test tjetër për arritjen e kriteve për integrimin në BE. Termi i përdorur shumë nga vëzhguesit ndërkombëtarë „*testi i demokracisë*“ vijoi të zerë rrënjë, por me kufizime të mëdha. Një afrim me standardet ndërkombëtare është arritur vetëm pjesërisht, edhe pse shumë vëzhgues i kanë vlerësuar këto zgjedhje lokale si më të mirat që janë zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri. Si shumë pozitiv për t'u vlerësuar është fakti se procesi zgjedhor, megjithë klimën politike jo të favorshme, mundi të zhvillohej plotësisht i qetë. Gjatë numërimit të votave në Tiranë, megjithatë u verifikuan disa përplasje të vogla të dhunshme.

### Zgjedhjet në një vend të polarizuar

Tensionet politike në Shqipëri janë kthyer në rend të ditës. Mes dy rivalëve kryesorë politikë ( PD dhe PS) qysh prej 20 vjetëve, jo vetëm që ka diferenca të mëdha në mendim, por edhe prirje e tendenca për thellim të përplasjeve. Debatit politik në Parlament, prej vitesh karakterizohet nga përplasjet permanente mes PD dhe PS mbi tema politike, mbi rregullsinë e procesit zgjedhor të 2009 dhe zënien e pozicioneve kyçe në gjykatat.

Parlamenti funksionon shumë i kufizuar, e një dialog politik konstruktiv, nuk duket të ndodhë. Politika bojkoton vetveten dhe gjendet në betejë permanente për

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

**SHQIPERI**

DR. WILLIBOLD FREHNER

**7 Qershor 2011**

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

dëmtimin apo menajnimin e kundërshtarit politik. Të gjitha sa u cituan më sipër, përbëjnë dëshmi se demokracisë në Shqipëri i duhet të përballet akoma me dhimbjet natale në rritje dhe se filizi i njomë demokratik shqiptar akoma duhet asistuar fort dhe mbështetur nga organizatat e huaja.

Zgjedhjet e 8 majit 2011, ishin të parat zgjedhje lokale që u zhvilluan pas ndryshimeve në kodin elektorale shqiptar në vitin 2008. Fatkeqësisht, kundërshtarët politikë afatgjatë, Kryeministri Berisha dhe lideri i opozitës, Rama, nuk mundën të binin dakord para zgjedhjeve lokale 2011 për reforma të tjera elektorale. Kjo duhej të ndodhte menjëherë pas zhvillimit të zgjedhjeve.

Tensionet politike në Shqipëri, qysh prej zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2009 mbetën edhe më tej të larta dhe të polarizuara, me retorikë të ashpër dhe sulme personale nga të dyja kampet politike dhe liderët e të dyja partive politike kryesore: PD, LSI, PR (nga kampi qeveritar) dhe PS (e parti të tjera nga kampi opozitar). Tensionet politike me bojkotim të parlamentit, me grevë urie dhe demonstrata nga ana e PS-së, kulmuan në aktivitetet e organizuara nga PS-ja më 21 janar 2011, të cilët mbartnin në vetvete edhe elementët më të fortë të një përpjekje për puç shteti e që çuan në përplasje të dhunshme, të cilat patën si pasojë katër të vdekur dhe qindra të plagosur.

PS-ja deri më sot e kësaj dite akoma nuk i ka njohur zyrtarisht rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare të 2009. Më 6 shtator 2010, Presidenti i Shqipërisë, dekretoi datën e zgjedhjeve lokale në mbarë vendin: 8 maj 2011. Kryebashkaikët dhe krerët e komunave të vendit si dhe këshillat bashkiakë të 384 njësisve zgjedhore u zgjodhën në zgjedhje të drejtpërdrejta. Sipas madhësisë së lokalitetit apo zonës zgjedhore, u votua për 13 deri në 55 këshilla bashkiakë, ndërkohë që në Tiranë ishin 55.

PS i bojkotoi për një kohë të gjatë përpjekjet për përgatitjet e zgjedhjeve. Lideri i opozitës, Edi Rama, argumentoi se zhvillimi i zgjedhjeve demokratike në një klimë të nxehtë politike në Shqipëri, nuk do ishte i mundur (duhet thënë se kjo klimë u nxeh akoma dhe më shumë si pasojë e veprimeve të tij personale). Në janar 2011, nga ana e PS-së u bojkotua edhe puna e KQZ-së (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

KQZ, i cili sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashihet si një institucion i rëndësishëm demokratik, kujdeset për organizimin e procesit të votimit dhe numërimin e nxjerrjen në mënyrë korrekte të rezultateve të votimit. Vetëm më 8 prill 2011, kur Rama, si lider i opozitës, pa se zhvillimii zgjedhjeve lokale nuk mund të pengohej më dhe kur bashkësia ndërkombëtare këmbëngulte në organizimin e këtyre zgjedhjeve, ai dërgoi më në fund anëtarët e emëruar nga opozita në KQZ.

### **Struktura të dobëta partiake në Shqipëri**

Ashtusikurse edhe në vende të tjera ish-komuniste, të cilat përjetuan për një kohë të gjatë sistemin monist, edhe shumica e partive me bazë demokratike në Shqipëri, nuk mund t'i referohen ndonjë tradite historike pozitive në këtë rast. Edhe si pasojë e këtyre arsyeve, partitë demokratike në Shqipëri bazohen vetëm në një bazë të vogël në shoqëri dhe sidoqoftë në një ekperiencë po aq të vogël në përballje me demokracinë.

Partia Socialiste u themelua në vitin 1991 (me bazë në ish-Partinë Komuniste), Partia Demokratike u themelua në vitin 1990 si shprehje e një lëvizje proteste studentore. Të gjitha partitë në Shqipëri kanë një strukturë organizative akoma të dobët, anëtarësi të ulët dhe një programatikë akoma të padetajuar e pëgjithësuese. Shpesh anëtarët e tyre grupohen rreth liderëve karizmatikë politikë (si për shembull: PD-ja rreth kreut të saj, Sali Berisha apo PS-ja rreth Edi

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

## SHQIPERI

DR. WILLIBOLD FREHNER

7 Qershor 2011

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Ramës). Demokracia e brendshme partiake ushtrohet vetëm në fazat e para.

Fondacioni „Konrad Adenauer“ përqipet - për këtë arsye - të ndihmojë, në tejkalimin e pikave të dobëta, sidomos brenda radhëve të PD-së. Në Shqipëri Fondacioni „Konrad Adenauer“, në sektorin e partive politike, synon bashkëpunimin me partitë konservatore të Qendrës, në përmirësimin e programit dhe të strukturave komunikative dhe organizative. Në seminarët që ai organizon, edukimi politik, ndërtimi i një menaxhimi eficient partiak, hartimi i strategjive moderne në fushatat elektorale dhe përmirësimi i imazhit, si dhe puna me publikun, qëndrojnë në qendër të vëmendjes.

### Përgatitja e zgjedhjeve

Në Ballkanin Perëndimor është e rëndësishme, jo vetëm të ndërmjetësohet mes vendeve në konflikt, si për shembull: në rastin e Kosovës dhe Serbisë. Edhe mes vendeve, si Shqipëria, prezenca e organizatave ndërkombëtare është e domosdoshme, për të dhënë ndihmesën e tyre në zgjidhjen e konflikteve (si për shembull: zgjidhja e konfliktit mes qeverisë dhe opozitës, e cila shpesh degjeneron në përplasje të dhunshme) dhe për të zhvilluar zgjedhje të rregullta e të ndershme. OSBE ndihmoi qysh në fillim të procesit përgatitjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe vëzhgoi rregullsinë e procesit gjatë zhvillimit të tyre.

OSBE vuri në dispozicion një ekip me 40 bashkëpunëtorë permanentë qysh prej 28 marsit 2011 për përgatitjen e zhvillimin e zgjedhjeve lokale në Shqipëri. 49 parti politike regjistruan kandidatë zyrtarë në mbarë vendin. 22 parti politike u gjendën të përfshira në koalicionin politik, të udhëhequr nga PD-ja. Ky koalicion u emërua „*Aleanca për qytetarin*“. 23 parti të tjera iu bashkangjitën koalicionit „*Aleanca për të ardhmen*“ që udhëhiqej nga PS-ja. Fushata zyrtare zgjedhore nisi më 8 prill 2011 – por partitë kishin nisur qysh më parë aktivitetet e

tyre partiake dhe paraqitjet në funksion të fushatës zgjedhore.

Edhe afatet e regjistrimit për partitë u vendosën me shumë zemërgjerësi: PS-ja fillimisht e kontestoi dhe refuzoi ditën e paracaktuar, megjithatë kjo parti pak ditë më vonë u lejua të regjistrohej nga KQZ për të marrë pjesë në zgjedhje.

Rreth 3,1 milionë zgjedhës (persona që kanë mbushur moshën 18 vjeç) ishin përcaktuar si të aftë për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 8 majit 2011. Votimi duhet të zhvillohej në mënyrë individuale, në zonën zgjedhore në të cilën zgjedhësi është regjistruar. Në zgjedhjet e fundit lokale, të mbajtura në vitin 2007, morën pjesë rreth 48 % e personave të cilësuar të aftë për të votuar. Në zgjedhjet e fundit vendore, në rang kombëtar u regjistrua një përqindje prej 51 %. Mangësitë dhe shtyrjet nëpërmjet gabimeve organizative gjatë dhënies së votës, e çuan këtë përqindje në Tiranë deri në masën e rreth 47 %. Një votim me postë në Shqipëri apo online, nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

### Vëzhgimi zgjedhor më 8 maj 2011

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) para zhvillimit të këtyre zgjedhjeve kishite akredituar rreth 4.700 vëzhgues lokale. Sëbashku me vëzhguesit ndërkombëtarë, ky numër shkonte në më shumë se 5.300 të thirrur të mbikqyrnin zgjedhjet e 8 majit 2011. Edhe nga Gjermania morën pjesë disa vëzhgues zgjedhorë. Në të gjitha 384 njësitë zgjedhore ku u votua, duke përfshirë një numër votuesish prej 1,5 milionë vetësh, numri i vëzhguesve për njësi vendore e numër zgjedhësish, rezultoi shumë i lartë. Vëzhguesit gjermanë raportuan në fakt për ngjarje e incidente të vogla e të lokalizuara – por se për Shqipërinë, këto zgjedhje ishin edhe një hap më tej drejt standardeve më të mira. Kjo ishte dhe pika e përbashkët në komentet e shumë vëzhguesve.

### Zgjedhjet vendore të vitit 2007 në Shqipëri

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

**SHQIPERI**

DR. WILLIBOLD FREHNER

**7 Qershor 2011**

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Zgjedhjet e fundmit të zhvilluara në Shqipëri u mbajtën më 18 shkurt 2007. Koalicioni i udhëhequr nga Edi Rama ( dmth. nga Partia Socialiste) arriti të fitonte asokohe shumicën e 384 bashkive e komunave, ndër to, thuajse të gjitha zgjedhjet për Kryetar Bashkie në qytetet e mëdha të vendit ( në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Berat, Gjirokastër dhe Vlorë). Vetëm Shkodra ( si një qytet i madh) mundi të fitojë nga koalicioni i djathtë, nën udhëheqjen e PD-së. Në mbarë vendin, sidoqoftë, koalicioni i partive të djathta fitoi rreth 47 % të votave, duke shënuar kështu edhe shumicën e votave të fituara. Rreth 43 % të votave i shkuan koalicionit socialist.

Veçanërisht në komunat dhe bashkitë e vogla, koalicioni i partive të djathta e konservatore dhe PD-ja mundi të arrinte rezultate të mira. Rreth 48 % e 2,9 milionë votuesve që morën pjesë në zgjedhjet e vitit 2007, arritën të shfrytëzonin si duhet të drejtën e tyre për të votuar.

Shumica e votave u ndanë mes partive të mëdha sipas kësaj renditje në rang vendi:

- Partia Socialiste (PS): 24,3 %
- Partia Demokratike (PD): 21,6 %
- Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI): 9,2 %
- Partia Republikane (RP): 5,5 %

Në zgjedhjet për Kryebashkiak në Tiranë, u arritën këto rezultate:

- Edi Rama (PS): rreth 56 % të votave
- Sokol Olldashi (PD) (Ministri aktual i Transporteve): rreth 43% të votave
- Vasil Kushi (Kandidat i Komunistëve): rreth një përqind të votave

**Veçoritë gjatë zgjedhjeve lokale nëpërmjet një mënyre speciale „votuesish besnikë“**

Nëpërmjet polarizimit të jetës politike, në Shqipëri, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve vendore haset një fenomen. Nocioni „votues besnik“ në Shqipëri ka një kuptim të veçantë: të gjithë punonjësit e administratës lokale gjatë zgjedhjeve të radhës votojnë në princip për atë kandidat që i ka sjellë dhe mbajtur ata në pozicionet që kanë në administratën lokale. Nëse arrihet sukses, dmth. një rizgjedhje e kandidatit të tyre, vendi i tyre i punës është relativisht i siguar. Nëse ndërrohet Kryebashkiaku, ndërrohet edhe e gjithë administrata e Bashkisë apo e Komunës. Kjo nuk i përgjigjet jo vetëm parimeve demokratike, por ka edhe pasoja të mëdha gjatë ndërrimit të Kryebashkiakut: nëpunës lokalë me përvojë pushohen nga puna. Klane të reja dhe nepotizëm del në skenë nga e para. E gjithë njohuria dhe përvoja e bashkëpunëtorëve shkon dëm, kur ata largohen.

**Rezultatet paraprake për „Lokalet 2011“**

Qysh prej zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2009, të dyja partitë e mëdha parlamentare kanë pësuar një farë ndryshimi. Gjatë fushatës zgjedhore të 2009, të dyja partitë e majta PS dhe LSI garonin kundër PD-së dhe gjithashtu edhe PR-ja në krah të PD-së. Pak kohë pas përfundimit të zgjedhjeve Parlamentare të 2009, LSI-ja ndryshon kahjen dhe bie dakord me PD-në dhe me Republikanët, të krijojë një koalicion qeveritar. Qysh prej asaj kohe, këto tri parti janë sëbashku me të tjera më të vogla, në një koalicion dhe po kështu u shfaqën edhe gjatë Zgjedhjeve Lokale të 2011.

PD dhe PS tradicionalisht kanë numëruar në Shqipëri një numër thuajse të barabartë e të madh zdhedhësish; LSI u rreshtua si partia e tretë më e madhe dhe PR e katërta në koalicionin me PD-në. E parë në terma thjesht matematikorë, pikërisht për këtë arsye u parashikua një fitore me një diferencë të lehtë për këtë koalicion në zgjedhjet vendore të 2011.

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

**SHQIPERI**

DR. WILLIBOLD FREHNER

**7 Qershor 2011**

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Nëse do të shihet numërimi i votave për anëtarët e këshillave bashiakë e komunalë, „*Aleanca për Qytetarin*“ ka kapur madje një shumicë prej 172.000 votash. Pjesëmarrja në këto zdhedhje (siç e përmendëm qysh në fillim) në rang vendi kapi shifrën e rreth 51 %. Në Tiranë, kjo pjesëmarrje shënoi kuotën e rreth 47 %. Në qytetet e mesme e të mëdha, PS arriti një fitore të lehtë ndaj PD-së (si për shembull: në Durrës, Elbasan, Korçë, Berat, Gjirokastër, Vlorë). Në komunat e bashkitë më të vogla, koalicioni i drejtuar nga PD-ja fitoi sërish shumicën e tyre. Në rajonin më të rëndësishëm qendror të vendit, Tiranë, e cila deri më tani përmban rreth një të tretën e popullsisë së vendit, PD, në Bashkinë e Tiranës dhe në ato rreth saj, Kamëz e Farkë, mundi të marrë Kryebashkiakun.

Deri në bërjen të ditur në mënyrë zyrtare të rezultateve përfundimtare në Tiranë, procedura zgjati deri më 4 qershor 2011. Partia Socialiste formuloi 17 ankesa me shkrim ndaj KQZ-së. PD ndërkohë nga ana e saj dërgoi 11 pretendime. Thuajse të gjitha ankimimet u refuzuan. Kjo, megjithatë nuk do të thotë se përplasjet dhe diskutimet mbi rregullsinë e procesit zgjedhor mes kampeve politike rivale, morën fund.

Deputeti Harasani nga kampi opozitar (PS), më datë 22 maj 2011, gjatë një paraqitje në TV, e parashtrori në këtë mënyrë situatën: Zgjedhjet vendore të 8 majit 2011 ishin më të mirat në historinë e Shqipërisë demokratike. Koalicioni i Edi Ramës i humbi këto zgjedhje me një diferencë prej më shumë se 70.000 votash. Rama, më në fund ia doli t'i shndërronte miqtë në armiq e kësisoj ta kthente PS-në në një parti humbëse.

### **Zgjedhjet për Kryebashkiakun në Tiranë**

Me interes të madh u prit gara për Kryebashkiakun në Tiranë. U regjistruan kësisoj zyrtarisht tri kandidatë:

- Lulzim Basha, ish-Ministër i Brendshëm, nga PD e koalicioni përkatës

- Edi Rama, lideri i opozitës dhe Kryebashkiaku në detyrë

- Hysni Milloshi, nga Partia Komuniste

Kandidatit të Partisë Komuniste iu parashikuan shance fare simbolike në këtë garë. Por pjesëmarrja e tij si kandidat i pavarur, i kushtoi shumë kampit të majtë në rezultatin përfundimtar, duke i hequr kësisoj vota shumë të rëndësishme Edi Ramës. Edi Rama ndërkohë ka qenë zgjedhur tri mandate rresht Kryetar i Bashkisë së Tiranës, duke e qeverisur qytetin në mënyrë të pandërprerë qysh prej dhjetë vitesh (periudha e parë: trevjeçare, e dyta: po tre dhe e treta: katër vjet). Për Edi Ramën, i cili njëkohësisht është edhe Kryetari i PS-së, kjo garë veçanërisht donte të thoshte shumë: Rama nuk është Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe kësisoj me postin që mbante si Kryebashkiak në Tiranë, ai kishte në dispozicion një pushtet të konsiderueshëm si lider i opozitës. PD-ja vuri në dispozicion një kandidaturë atraktive me Lulzim Bashën si kundërpeshë: Basha, i lindur në 1974, i përket elitës së re të politikanëve në Shqipëri. Ai ka studiuar drejtësi në Utrecht të Holandës, flet shumë gjuhë të huaja, ka qenë bashkëpunëtor i Gjykatës së Lartë të Krimeve të Luftës në Hagë (ku ka marrë pjesë edhe në përgatitjen e aktpadisë ndaj ish-Presidentit serb, Slobodan Millosheviç).

Basha i përket Kabinetit të Kryeministrit, Sali Berisha qysh prej shtatorit të vitit 2005. Ai ka qenë Ministër për Punët Publike, Transportin dhe Telekomunikacionin (2005 – 2007), Ministër i Jashtëm (2007 – 2009), Ministër i Brendshëm (2009 – 2011) dhe vlerësohet si kandidati potencial brenda PD-së, nëse diskutohet mbi pasardhësin e Kryeministrit Berisha.

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

SHQIPERI

DR. WILLIBOLD FREHNER

7 Qershor 2011

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Për Edi Ramën, fushata zgjedhore nuk ishte e lehtë. Rama kishte tri role për të përmbushur: Ai është Kryetari i Partisë Socialiste, ai në mbarë vendin shihet si rivali direkt e jetëgjatë i Kryeministrit Berisha, ai ishte sërish kandidat i PS-së për postin e Kryebashkiakut të Tiranës. Në PD rolet ishin ndarë në persona të ndryshëm: lideri i partisë është Sali Berisha; Berisha është Kryeministri i vendit dhe gjatë fushatës zgjedhore lokale të këtij viti, drejtoi në rang kombëtar këtë fushatë për PD-në dhe Koalicionin, i cili si kandidat për postin e Kryebashkiakut për Tiranën kishte z. Basha. Zoti Basha, në mënyrë qëllimshme u paraqit si kandidat përballë Edi Ramës.

Fushata mes Ramës e Bashës për postin e Kryebashkiakut të Tiranës shënoi diferenca të mëdha mes dy kandidatëve:

- Rama zhvilloi një fushatë shumë negative ( damkosja e kundërshtarit, sidomos Berishës dhe Bashës, në rang lokal e kombëtar). Kjo gjë nga njëra anë, sigurisht se çoi në motivimin e disa përkrahësve, por nga ana tjetër, solli një polarizim të skajshëm. Një fushatë e tillë motivoi nga ana tjetër, edhe kundërshtarët e tij dhe i bëri të pavendosurit të anonin më shumë nga kampi i PD-së e të partive të tjera në koalicion me të;

- Basha zhvilloi një fushatë të mirëorientuar drejt objektivave konkretë dhe paraqiti idetë e tij mbi zhvillimin e ardhshëm të qytetit të Tiranës. Rama, i detyruar në një farë mënyre të bënte të njejtën gjë, reagoi pak ditë më pas, duke sjellë në vëmendje pak a shumë të njejtat ide, porse nuk mundi dot të shpjegonte se pse ai nuk kishte mundur dot t'i vinte në zbatim këto plane gjatë tri mandateve të tij në krye të Bashkisë së kryeqytetit.

Pika më e rëndësishme megjithatë ishte: shumë qytetarë të Kryeqytetit ishin të pakënaqur me drejtimin e

Ramës gjatë viteve të shkuara. Pika të rëndësishme në këtë argument janë:

- zhvillimi i deritanishëm i qytetit, gjendja e qarkullimit dhe transportit, furnizimi me ujë të pijshëm, menaxhimi i plehrave dhe ujrave të zeza, nuk ishin të kënaqshme;

- Deri më tani nuk u panë të viheshin në zbatim plane të koordinuara të zhvillimit urban, të qarkullimit të automjeteve dhe të investimeve në Tiranë;

- shërbimi dhe oferta e administratës së qytetit nuk është e mirë;

- Administrata është e përbërë mbi baza klienteliste;

- Për qytetarët, situata financiare e qytetit nuk është transparente, as të ardhurat e as shpenzimet nuk bëhen të njohura për publikun;

- për qytetarin nuk përftohet një ide se si përdoren taksat e kontributet e mbledhura prej tyre.

### Rezultate paraprake të zgjedhjeve vendore në Tiranë

Më 23 maj 2011 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli z. Lulzim Basha si fitues të garës për Kryebashkiakun e Tiranës. Ai fitoi me 81 vota diferencë ( rezultati: 124.786 me 124.705) ndaj kandidatit Edi Rama. Rezultati u kontestua nga PS. Pretendimet u shqyrtuan më pas nga Kolegji Zgjedhor, i cili i ktheu ato mbrapsht.

Interesant është edhe vlerësimi i kandidatëve në krahasim me partitë që i mbështesnin nga ana e zgjedhësve:

- Lulzim Basha arriti ( me rezultatin e tij prej 124.786 votash) 50.256 vota më shumë se PD në Tiranë (74.530 vota)

- Edi Rama arriti 23.923 vota më shumë se sa PS, e cila në Tiranë arriti kuotën e 100.783 votave.



Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

**SHQIPERI**

DR. WILLIBOLD FREHNER

**7 Qershor 2011**

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Kjo do të thotë se Lulzim Basha në Tiranë shihet me më shumë pozitivitet se sa vetë Partia Demokratike.

Numri i votave për kandidatin e Partisë Komuniste, në krahasim me dy rivalët e tij, qëndronte shumë poshtë. Hysni Milloshi arriti të merrte gjithsej 1.394 vota. Këto vota i munguan më shumë pikërisht kampit të majtë për postin e kryebashkiakut.

Partia Socialiste ngriti disa herë me radhë pretendimet dhe kontestimet e saj edhe kundër KQZ-së në lidhje me rezultatin për Kryebashkiakun e Tiranës. Kolegji Zgjedhor vendosi t'i kthente mbrapsht pretendimet e PS-së. Fituesi i zgjedhjeve për Bashkinë e Tiranës në fund u zgjodh falë një difference të lehtë votash dhe ai e ka emrin: Lulzim Basha.

### **Përfundimet që dalin pas zhvillimit të zgjedhjeve lokale të 8 majit 2011**

Rezultati për PD (sëbashku me koalicionin e udhëhequr prej „*Aleanca për qytetarin*“) me një shumicë prej 70.000, dmth prej 172.000 votash, në mbarë vendin nuk ishte surprizues. Sidomos pjesa e votave të vjela nga PD në Tiranë dhe në qytete të mëdha është mëse pozitive.

Zgjedhja e Kryebashkiakut Basha, rritja e numrit të votave për kandidatin e PD-së në Tiranë, fitorja e bashkive dhe komunave rreth Tiranës, Kamza dhe Farka si dhe në kështjellën tradicionale demokrate, Shkodër, tregojnë se kjo Parti edhe në rrafshin urban ka mundur të mobilizojë zgjedhës, nëse paraqiten kandidatë të mirë dhe programe bindëse e me përmbajtje për zhvillimin e komunave e bashkive përkatëse, të cilat miratohen nga votuesit.

Fitoret e PS në qytetet e tjerë me peshë, tregojnë nga ana tjetër, se deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare që do mbahen në vitin 2013, duhet të punohet akoma edhe më shumë për imazhin qeverisës dhe të vetë PD-së, si edhe të zbatimit të një politike më pranë

qytetarit – përndryshe, zgjedhjet parlamentare të 2013 nuk do të sillnin një rezultat të suksesshëm për PD. Gjë e cila mund të vlerësohet pozitivisht nga pikëpamja e PD-së, është fitorja e zgjedhjeve në Tiranë, Kamëz e Farkë. Këto tri bashki përbëjnë edhe bërthamën e një rajoni të madh që po njuh rritje në qendër të vendit. Me këtë hap është hedhur edhe baza, për një plan të mirëkoordinuar, gjithpërfshirës e të mirëdeuar urban për mbarë rajonin e Tiranës, i cili në një të ardhme jo të largët, do të mbajë në gjirin e vet rreth gjysmën e popullsisë së vendit, duke paraqitur qysh tani në fakt, rajonin më të rëndësishëm ekonomik të Shqipërisë.

Rezultatet e Zgjedhjeve Parlamentare të 2009 në Shqipëri, në shumë bashki e komuna ishin shumë të ngushta dhe shpesh objekt përplasjesh mes kampit qeveritar e atij opozitar. Debati i ndezur zgjati dy vjet dhe çoi në prishjen e rendit publik duke sjellë trazira me bazë politike që shkaktuan edhe viktime. Kjo solli sërish pasoja negative për investimet, turizmin dhe mbarë zhvillimin ekonomik. Zgjedhjet e zhvilluara për Kryebashkiakun në Tiranë (2011) ishin sidoqoftë sërish të diskutueshme dhe sollën rezultat thuajse të barabartë mes palëve, procesi i numërimit u zgjat tej mase. Mbetet të shpresojmë se edhe kjo betejë mbi rezultatin përfundimtar të këtyre zgjedhjeve mes dy kampeve politike, nuk do të zgjasë më dy vjet derisa të vijë koha për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

### **A janë zgjedhjet në Shqipëri korrekte sipas standardeve të BE-së?**

Nga ana e BE-së është theksuar shpesh deri më tani se zhvillimi korrekt i zgjedhjeve përbën një test të rëndësishëm për Shqipërinë, për arritjen e synimeve të anëtarësimit në BE. Zgjedhjet ishin sigurisht më të mirat vendore të zhvilluara ndonjëherë në historinë e Shqipërisë, por standardet e BE-së në këtë aspekt u arritën pjesërisht.

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

**SHQIPERI**

DR. WILLIBOLD FREHNER

**7 Qershor 2011**

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

Përgatitja e zgjedhjeve ishte e përshkruar nga plot kompromise të diktuar nga koha e përmbajtja, nisur qysh nga mosrespektimi i datave të përcaktuara në ligj për regjistrimin e partive politike në KQZ. Vetëm me koncesione kohore u bë e mundur të sigurohej pjesëmarrja e PS në këto zgjedhje. Dita e zgjedhjeve mundi të përcaktohej vetëm me anë kompromisesh e po ashtu koncesionesh: dyndja e njerëzve në Tiranë gjatë votimit, për shkak të mangësive organizative, mezi mundi të përballohej.

Votuesit e moshuar - për shkaqe subjektive - u desh të ktheheshin nëpër shtëpia, pasi nuk ishin në gjendje të prisnin aq gjatë në radha, derisa të jepnin votën e tyre. Në disa vendvotime u lejua madje votimi deri në orën 22.00 (orari limit për votim ishte përcaktuar ora 19.00), sepse përndryshe, dyndja e njerëzve do të kishte qenë e papërballueshme. Në Tiranë, numërimi i votës së fundit u bë i mundur vetëm pas dy javëve pas përfundimit të procesit të votimit. Rëndësi e madhe iu vu me këtë rast transparencës gjatë numërimit të votave. Nga rreth 250.000 vota të hedhura, një numërim në një hapësirë prej dy javësh, sigurisht se nuk është një rezultat pozitiv.

Standardi në procesin e votimit dhe në atë të numërimit të votave edhe në Kosovë është më i lartë. Numërimi i votave u shoqërua me probleme të mëdha: u bënë përpjekje, sigurisht që çdo gjë të transmetohej "live" nëpër TV, duke arritur kështu një shkallë të lartë transparence. Nga ana tjetër, u vu re një kaos i madh, pasi fletët e votimit për zgjedhjen e Kryebashkiakut u hodhën gabimisht apo me nxitim jo në kutitë e përcaktuara. Pas kësaj shpërtheu një debat i ashpër, nëse këto vota do të duhej të numëroheshin si vota për Kryetarin e Bashkisë, apo jo.

Një aspekt pozitiv i fushatës së kandidatit të PD-së, z. Basha në Tiranë, ishte ai u përpoq të sillte në vëmendje

pikësëpari tema konkrete, duke e vendosur zhvillimin e qytetit në plan të parë të argumenteve të tij dhe anashkaluar me qëllim damkosjen e kundërshtarit. Kjo bëri që edhe rivali tij, Rama, të detyrohej më shumë të sillte argumente dhe koncepte konkrete, duke reduktuar ofendimet e sharjet ndaj kundërshtarit.

E parë në tërësi, është e rëndësishme që para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, të ndërmerren të tjera reforma zgjedhore, në mënyrë që në qytetet e mëdha të mundësohet eventualisht edhe nuëmrimi elektronik dhe që para së gjithash defektet e vëna re në proceset e mëparshme gjatë dhënies së votës dhe gjatë numërimit, të shmangen. Për të tilla reforma, katër partitë e mëdha PD, PS, LSI dhe PR kanë bërë thirrje ndërkohë në mënyrë direkte.



Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

Dokument i bashkangjitur:

SHQIPERI

DR. WILLIBOLD FREHNER

7 Qershor 2011

[www.kas.de](http://www.kas.de)

[www.kas.de/albanien](http://www.kas.de/albanien)

<b>Zgjedhjet Lokale në Shqipëri - 8 Maj 2011</b> <b>Votimi sipas Koalicioneve dhe Partive udhëheqëse</b> <b>(Votat e dhëna për Kryebashkiakun)</b>			
Emrii Koalicionit	Vota gjithsej në Shqipëri	Votat gjithsej të fituara nga PD / PS në rang vendi	Votat e fituara nga PD / PS në Tiranë
“Aleanca për Qytetarin”, kryesuar nga PD	733.520	303.480	75.530
“Aleanca për të Ardhmen”, kryesuar nga PS	662.630	400.000	100.783